



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ____/____/202__

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 1581683 (NJË MILION E PESËQIND E
TETËDHJETË E NJË E GJASHTËQIND E TETËDHJETË E TRE) LEKË TË
PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI TERRAIN, PROGRAMI
INTERREG IPA ADRION (2021-2027)

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 65/2022 "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Europian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës-financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)", Ligjit nr. 73/2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Rajoni i Emilia – Romagna-s, dhe Komisionit Evropian, për programin Interreg (Interreg VI-B) IPA Adriatik – Jon", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115 datë 24.12.2024 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025", Udhëzimit nr.10 datë 12.07.2024 "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordinin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmjet Partnerit Lider Centre for Research and Technology Hellas/Hellenic Institute of Transport dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 15/11/2024, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Turizmit, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Të miratojë përdorimin e fondit prej 1.581.683 lekë, të ardhur si paraфинancim nga projekti TERRAIN. Ky fond do të përdoret sipas të dhënave në tabelën si më poshtë vijon:

Gr.	Kap.	Programi	Llog. Ekon	Kodi i programit	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Fondi në lekë
00	2	Transporti publik	602	04570	2107001	Bashkia Durrës	Projekti TERRAIN	G107007	1.581.683

2. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtor
Valbona Qiriako

DREJTORIA E TURIZMIT

Drejtor
Lorenc Smajli

DREJTORIA LIGJORE

Drejtor
Alneida Rroshi

KRYETAR

Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Nr. ____ Prot.

Durrës, më ____ . ____ . 2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 1581683 (NJË MILION E PESËQIND E TETËDHJETË E NJË E GJASHTËQIND E TETËDHJETË E TRE) LEKË TË PARAFINANCUARA NGA PROJEKTI TERRAIN, PROGRAMI INTERREG IPA ADRION (2021-2027)

Në mbështetje të Ligjit nr. 65/2022 "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)", Ligjit nr. 73/2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Rajoni i Emilia -- Romagna-s, dhe Komisionit Evropian, për programin Interreg (Interreg VI-B) IPA Adriatik -- Jon", Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 63/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.10 datë 12.07.2024 "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmjet Partnerit Lider Centre for Research and Technology Hellas/Hellenic Institute of Transport dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 15/11/2024, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Turizmit kanë përgatitur Relacionin për alokimin e fondeve të parafinancuara nga Projekti "Twinning and Engagement in net-zero tRansport tRAnslition"-TERRAIN, programi i BE së Interreg IPA ADRION (2021-2027), me kod produkti G10/007 (referuar Financial Identification Form bashkëlidhu.).

Referuar Marrëveshjes së Partneritetit të nënshkruar ndërmejt Partnerit Lider Centre for Research and Technology Hellas/Hellenic Institute of Transport dhe institucionit të Bashkisë Durrës, nënshkruar më datë 15/11/2024, Bashkia Durrës është përfutuese e projektit TERRAIN - Twinning and Engagement in net-zero tRanport tRAnslitioN - të financuar nga programi i BE-së Interreg IPA ADRIION. Ky projekt do të zgjasë 36 muaj (1/9/2024 – 31/8/2027). Kodi i produktit të projektit të ardhur ng Dega e Thesarit Durrës dhe të konfirmuar nga Ministria e Financave është: G107007.

Buxheti total i projektit për institucionin e Bashkisë Durrës është: 94.320,20 Euro, nga të cilat:
- **80.235,92 Euro (ose 85%)** do të financohen nga fondet e programit Interreg IPA ADRIION
- **14.159,28 Euro (ose 15%)** si bashkëfinancim nga fondet e Bashkisë Durrës.

Sipas Udhëzuesit të Aplikimit të Thirrjes së I-rë të IPA ADRIION pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Partneritetit, do të bëhet disbursimi i shumës së parafinancimit nga partneri udhëheqës.

Shuma e disbursimit të parafinancimit është në vlerën 20% të shumës së financimit të projektit nga fondet e programit Interreg, pra në vlerën 16,047 Euro ose 1.581.683 lekë.

Transferimi i shumës së parafinancimit në vlerën 1.581.683 lekë është bërë në muajin maj të vitit 2025 në llogari të Projektit TERRAIN me kod produkti G107007. Kjo shumë do të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për zhvillim të aktiviteteve për vitin 2025 e në vazhdim, si: ekspertiza të jashtme dhe shërbime për takime lokale, udhëtime jashtë vendit, kancelari dhe përkthim/noterizim.

Qëllimi i Projektit

TERRAIN promovon lëvizshmërinë urbane të qëndrueshme në Rajonin Adriatiko-Jonian duke nxitur bashkë-planifikimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Nëpërmjet mentorimit, laboratoreve të gjalla/living lab dhe zgjidhjeve të lëvizshmërisë inteligjente, TERRAIN synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen si edhe të reduktojë emetimet përmes përmirësimit të lëvizshmërisë multimodale për qytete të qëndrueshme dhe pa karbon/zero karbon.

Bazuar në shkëmbimin e përvojave dhe bashkë-projektimin, Projekti TERRAIN synon të udhëheqë dhe lehtësojë kalimin e qyteteve të Makro-rajonit Adriatiko-Jonian në një lëvizshmëri urbane të qëndrueshme dhe inteligjente (për më shumë vizitoni faqen zyrtare të internetit të projektit: <https://www.interreg-ipa-adriion.eu/>). Së bashku me Qendrën për Kërkim dhe Teknologji Hellas/Institutin Helenik të Transportit (CERTH/HIT) si udhëheqës horizontal të projektit, 9 qytete të zonës së Programit janë përfshirë në një bashkëpunim trevjeçar për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive, duke i ndihmuar ato të ndërtojnë qytete pa emetime/zero emetime në lidhje me lëvizshmërinë sipas direktivave të BE-së. Partneriteti përfshin entitete që përfaqësojnë 4 qytete nga vendet evropiane të programit ERDF, të cilat janë pjesë e iniciativës “Qytete të klimës neutrale dhe inteligjente” (Janina - Greqi, Bolonja - Itali, Ljubljana - Slloveni, Zagreb - Kroaci) dhe 5 nga qytetet më të mëdha të vendeve përfutuese të Programit IPA (Sarajevë - Bosnjë dhe Hercegovinë, Berane - Mali i Zi, Pančevo - Serbi, Shkup - Maqedonia e Veriut, Durrës - Shqipëri).

Roli dhe përgjegjësitë kryesore të Bashkisë Durrës (PP10):

Si pjesë e projektit TERRAIN, Bashkia Durrës do të marrë pjesë në aksionet dhe nismat për transportin pa emetime, duke zbatuar plane pilote, duke organizuar vizita studimore ndërkufitare apo takime me grupet e interes (4 living lab meetings), shkëmbime të eksperiencave dhe përvojave me vendet partnere për promovimin e lëvizshmërisë urbane pa emetime/zero emetime.

Kështu, Bashkia Durrës do të jetë përgjegjëse për zbatimin e Aksionit Pilot: përmirësimi i sistemit informativ të transportit publik, përmes ekraneve dhe pajisjeve ICT. Projekti pilot përfshin instalimin e një pajisjeje gjeolokacioni brenda flotës së transportit publik të Durrësit, e cila do të mundësojë detektimin në kohë reale të vendndodhjes së mjeteve. Për më tepër, pjesëmarrja në projektin TERRAIN lejon Bashkinë Durrës të ndërtojë partneritete të reja me vendet e tjera partnere të projektit.

Bashkia Durrës, përveç shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave më të mira të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve partnere në projekt, do të jetë përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit: Përmirësimi i sistemit informativ të transportit publik, vendosja e ekraneve dhe instalimi i pajisjeve TIK. Ky projekt falë planit pilot do të mundësojë zbatimin e një sistemi TIK ndërmjet flotës së transportit publik dhe një sistemi të menaxhimit të të dhënave, duke synuar të japë informacion në kohë reale për oraret e mbërritjes së autobusave. Ky projekt merr një rëndësi të madhe për qytetin e Durrësit, pasi për here të parë do të instalohen pajisje inovatore për të përmirësuar ofrimin e shërbimit të transportit publik në qytet.

Projekti pilot konsiston në instalimin e një pajisjeje gjeolokacioni brenda flotës së autobusave të Transportit Publik Lokal/LPT Durrës, e aftë për të zbuluar vendndodhjen në kohë reale. Ky informacion transmetohet në server ku futet në një algoritëm që merr parasysh të dhënat e trafikut nga shërbimet e Google. Pasi të përcaktohet koha e nevojshme për mbërritjen e automjetit, informacioni transmetohet në ekranet e instaluara në tre kryqëzimet e transportit publik lokal dhe терминаlet kryesore të autobusëve: Stacioni Verior; Stacioni Jugor dhe Sheshi Qendror pranë stacionit të Hekurudhës.

Rezultatet e përgjithë që priten nga zbatimi i projektit:

- Krijimi i nëntë (9) living labs/laboratoreve të gjalla në qytetet dhe rajonet pjesëmarrëse, për të shërbyer si platforma për zgjidhje inovative të mobilitetit dhe projekte pilote.
- Zbatimi i masave për të reduktuar ngarkesën e trafikut.
- Përdorimi i rritur i mundësive të transportit me emetime të ulëta dhe pa emetime/zero emetim.

- Përmirësimi i cilësisë së ajrit të zonave urbane përmes promovimit të mundësive të transportit ekologjik dhe promovimit të mobilitetit jo-motorik.
- Pjesëmarrja aktive e komunitetit lokal në projektimin, marrjen e vendimeve dhe zbatimin e zgjidhjeve të lëvizshmërisë/mobilitetit.
- Lehtësimi i shkëmbimit të njohurive përtej kufijve midis qyteteve të rajoneve ESRR dhe IPA.
- Krijimi i zgjidhjeve të lëvizshmërisë/mobilitetit që mund të replikohen dhe aplikohen në qytete dhe rajone të tjera përtej kuadrit të projektit.

Qyteti i Durrësit ka nisur ndërhyrjet për menaxhimin e flukseve të lëvizshmërisë, duke ofruar infrastrukturë më të madhe për këmbësorët dhe çiklistët. Tani është koha që Transporti Publik Lokal/TPL të ndërmarrë hapat e saj të parë drejt një përmirësimi. Ky është një hap i vogël drejt komunikimit me përdoruesit se linjat TPL janë të unifikuara dhe se ekziston një orar shërbimi që mundëson përdorimin intermodal në qytetin tonë. Nëpërmjet këtij aksioni pilot synojmë të shfrytëzojmë sa më mirë të dhënat e mbledhura dhe për më tepër synojmë të rrisim aplikimin e qartë të tyre brenda territorit të bashkisë.

Aktivitetet kryesore të projektit (2025-2026)

Ky projekt është i grupuar në 3 Paketa Pune/Working Packages

WP 1: Skicimi i zonës së veprimit për projektin TERRAIN

Aktiviteti 1.1 Specifikimi i vizionit të transportit neto zero në qytetet partnerë në projektin TERRAIN (viti 2025 e në vazhdim)

Aktiviteti 1.2 Ngritja e Living Labs dhe ngritja e qendrës së ekselencës së projektit TERRAIN dhe veprimet e lidhura me kapitalizimin e njohurive (viti 2025 e në vazhdim)

WP 2: Binjakëzimi ndërmjet qyteteve të projektit TERRAIN, shkëmbimi i përvojës dhe bashkëkrijimi i të ardhmes së lëvizshmërisë së qëndrueshme urbane

Aktiviteti 2.1 Grumbullimi dhe mentorimi i ndërhyrjeve të transportit neto zero (viti 2025 e në vazhdim). Shpjegim: zero neto nënkupton uljen e emetimeve të karbonit në një sasi të vogël të emetimeve të mbetura që mund të absorbohen dhe ruhen në mënyrë të qëndrueshme nga natyra dhe masat e tjera të heqjes së dioksidit të karbonit, duke lënë zero karbon në atmosferë.

Aktiviteti 2.2 Vizita studimore transnacionale, klinika bashkë-krijuese të ndërhyrjes dhe shkëmbimi i përvojaave të lëvizshmërisë urbane me vendet/qytetet që kanë nisma Net-Zero (viti 2025 e në vazhdim)

Aktiviteti 2.3 Komunikimi, Angazhimi dhe Bashkëkrijimi në Living Labs të qyteteve/vendeve anëtare të projektit TERRAIN (viti 2025 e në vazhdim)

Si pjesë e projektit TERRAIN, Bashkia Durrës ka ngritur tashmë Living Lab me përfaqësues nga grupe të ndryshme të interesit. Bashkia Durrës ka detyrimin të organizojë 4 takime të Living Lab. Deri më tani Bashkia Durrës ka organizuar takimin e parë me grupet e interesit, më konkretisht më 28 janar 2025, dhe do të duhet të organizojë edhe 3 takime të tjera. Ndërkohë, gjatë muajit korrik 2025, ka parashikuar të organizojë takimin e 2 me anëtarët e Living Lab. Anëtarët e Living Lab do të analizojnë bashkërisht, do të marrin vendime, do të zbatojnë dhe do të monitorojnë rezultatet e aksioneve pilote për promovimin e lëvizshmërisë së qëndrueshme dhe ndërmarrjen e nismave për të kaluar në transportin pa karbon/zero karbon.

Për zhvillimin e këtij aktiviteti janë parashikuar dy zëra buxhetore: ekspertizë e jashtme dhe shërbime/external expertise and services, shpenzime këto që do të kryehn brenda vitit 2025.

Aktiviteti 2.4 Planet e veprimit të qyteteve/vendeve partene në projektin TERRAIN (2025 e në vazhdim)

Aktiviteti 2.5 Veprimet pilote të qyteteve/vendeve partenere të TERRAIN (viti 2026)

Bashkia Durrës brenda periudhës 18 mujore nga fillimi i projektit që në shtator të vitit 2024, duhet të zbatojë planin e veprimit: Përmirësimi i sistemit informativ të transportit publik, vendosja e ekraneve dhe instalimi i pajisjeve TIK. Ky plan do të mundësojë zbatimin e një sistemi TIK ndërmjet flotës së transportit publik dhe një sistemi të menaxhimit të të dhënave, me qëllim ofrimin e informacionit në kohë reale për oraret e mbërritjes së autobusëve (të instalimit të një pajisjeje gjeolokacioni brenda flotës së autobusëve të Transportit Publik Vendor/LPT Durrës, e aftë për të zbuluar vendndodhjen e tyre në kohë reale).

Aktiviteti 2.6 Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të qyteteve/vendeve partnere në projektin TERRAIN (viti 2025 e në vazhdim)

Aktiviteti 2.7 TERRAIN net-zero lëvizshmëria urbane, ndryshimi i politikave dhe vlerësimi i ndryshimeve strukturore (viti 2025 e në vazhdim)

Aktiviteti 2.8 Hartimi i një udhërrëfyes strategjik për kalimin në sisteme transporti të qëndrueshme dhe neutrale ndaj karbonit (viti 2025 e në vazhdim)

WP 3: Komunikimi

Aktiviteti 3.1 Komunikimi i brendshëm ndërmjet vendeve partnere (viti 2025 e në vazhdim)

Aktiviteti 3.2 Komunikimi në publik i objektivit, aktivitetëve dhe rezultateve të projektit (viti 2025 e në vazhdim)

për sa më sipër, kërkojmë miratimin e përdorimit të fondit prej 1.581.683 lekë, të ardhur si parafinancim nga projekti TERRAIN. Ky fond do të përdoret sipas të dhënave në tabelë:

Gr.	Kap.	Programi	Llog. Ekon	Kodi i programit	Kodi i institucionit	Emri i institucionit	Emërtimi i projektit	Kodi i projektit	Fondi në lekë
00	2	Transporti publik	602	04570	2107001	Bashkia Durrës	Projekti TERRAIN	G107007	1.581.683

DREJTOR

Valbona Qiriako



DREJTOR

Ernal Lulio



DREJTOR

Lorenc Smajli

